

TELEFONONI LINJËN TELEFONIKE TË  
RAPORTIMIT TË MASHTRIMEVE NË:  
(718) 557-1399



Department of  
Social Services

Human Resources  
Administration

Department of  
Homeless Services



BRC-151 (AL)  
Rev. 05/23

© E drejta e autorit 2023, Administrata e Burimeve Njerëzore të Qytetit të Nju-Jorkut/Departamenti i Shërbimeve Sociale. Për leje për të shumëfishuar të gjithë ose një pjesë të këtij materiali, kontaktoni Administratën e Burimeve Njerëzore të Qytetit të Nju-Jorkut.

# BYROJA E HETIMIT TË MASHTRIMEVE (BUREAU OF FRAUD INVESTIGATION)

Mashtrimi për ndihmë ekonomike na dëmton të gjithëve, sidomos njerëzit që kanë vërtet nevojë për ndihmë.



**NYC** Human Resources  
Administration  
Department of  
Social Services

## MASHTRIMI PËR NDIHMË EKONOMIKE MUND TË NDIKOJË NË PËRFITIMET TUAJA

Mashtrim quhet kur keni për qëllim të keqinterpretimi, fshihni, ose të mos tregoni fakte në mënyrë që të merrni përfitimet e shërbimeve sociale.

Mashtrimi dëmton njerëzit që kanë nevojë për ndihmë, shpërdoron dollarë të taksave dhe bën që publiku të krijojë dyshime për shërbimet si përfitimet e Ndihmës ekonomike, Medicaid dhe përfitimet e Programit për Ndihmën Ushqimore Suplementare (Supplemental Nutrition Assistance Program). Mashtrimi mund të shkaktojë shkurtime në grantin tuaj mujor dhe në të gjitha programet.

### RAPORTONI MASHTRIMET E DYSHUARA

Mos u bëni pjesë e problemit; bëhuni pjesë e zgjidhjes. Nëse jeni në dijeni se dikush po abuzon me sistemin kontaktoni BFI-në në:

**LINJËN TELEFONIKE TË BFI PËR RAPORTIMIN E**

**MASHTRIMEVE** në numrin (718) 557-1399,

**NË INTERNET:** [www.nyc.gov/hra](http://www.nyc.gov/hra)

**OSE NA SHKRUANI NË:**

BFI Complaint Unit

375 Pearl Street, 23rd Floor

New York, NY 10038

Nuk keni pse të na jepni emrin tuaj dhe i gjithë informacioni që na jepni është konfidencial. Sa më shumë informacion të na jepni, aq më e lartë është mundësia që të ndalojmë mashtrimin.

### DUHET TË RAPORTONI

Punët me kohë të plotë ose të pjesshme, të deklaruar ose jo

Ndryshimet e adresës

Ndryshimet në numrin e personave në familjen tuaj

Pagesat e mbështetjes financiare për fëmijën

Shpërblimet e punonjësit, pagesat e invaliditetit ose të ardhurat nga sigurimi suplementar (Supplemental Security Income)

Përfitimet e veteranëve

Përfitimet e sigurimit për papunësinë

Përfitimet e sigurimeve shoqërore ose pensionet

Sigurimin për jetën

Pronësinë e automjeteve

Llogaritë rrjedhëse/të kursimit

Zotërimin e pronave

Para të tjera që merrni

## MOS GUXONI. MUND TË ARRESTOHENI

### NËSE KRYENI MASHTRIM:

- Mund të shkoni në burg.
- Duhet të ktheni mbrapsht të gjitha paratë që keni përfituar nga mashtrimet.
- Mund t'ju ndërpritet ndihma ekonomike, Programi për Ndihmën Ushqimore Suplementare dhe Përfitimet e Medicaid.

Duhet të raportoni çdo informacion që mund të ndryshojë përfitimet tuaja.

Nëse nuk e plotësoni aplikimin në mënyrë të plotë dhe të sinqertë, mund të jeni duke kryer mashtrim për ndihmë ekonomike.

Personat që kryejnë krime të mashtrimit për ndihmë ekonomike janë duke dëmtuar personat që kanë vërtet nevojë për ndihmë ekonomike. Duam të sigurohemi që përfitimet nga ndihma ekonomike të ndihmojnë personat në nevojë.



### SI E LUFTON BFI-JA MASHTRIMIN

Byroja e Hetimit të Mashtrimeve kryen hetime të ankesave për mashtrime të përfitimit të ndihmës ekonomike, Programit për Ndihmën Ushqimore Suplementare dhe Medicaid të kryera nga pjesëmarrësit dhe të tjerët. Mijëra çështje hetohen çdo vit.

BFI-ja ka një staf hetuesish profesionistë shumë të trajnuar që marrin informacione nga publiku, agjenci të ndryshme ligjzbatuese dhe agjenci të tjera të administratës vendore.

Duhet të raportoni çdo ndryshim lidhur me të ardhurat, kushtet e jetesës, adresën, pronën ose nevojat. Është përgjegjësia juaj t'i tregoni menjëherë Qendrës së Punës, Qendrës së Programit për Ndihmën Ushqimore Suplementare ose zyrës së Medicaid.

**JA VLEN TË RAPORTONI TË ARDHURAT E FITUARA DHE/OSE BURIMET TUAJA!**